



COVID-19 CHECKLIST PËR PËRDORIM TË QENDRAVE SHËNDETËSORE

Kjo checklist – ë është hartuar për t'u përdorur nga mjekë dhe staf tjetër mjekësor të cilët punojnë pranë qendrave shëndetësore në Bashkinë Rrogozhinë, si përgjigje ndaj situatës së krijuar nga COVID – 19. Materiali është pjesë e një përpjekje për të përmirësuar bashkëpunimin midis shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve sociale të ofruara në nivel vendor, veçanërisht ndaj grupeve të marginalizuara. Kjo checklist – ë shërben si një udhëzues dhe nuk është tërësisht shteruese. Mbetet në gjykimin e administruesit të saj për të bërë pyetje të mëtejshme ose për të marrë masa shtesë në varësi të secilit rast.

Mosha:

Gjinia:

Etniciteti: Shqiptar, Grek, Rom, Egjiptian, Arumun, Maqedonas, Ashkalit, Sërbo – Malazez, Tjetër (specifiko) _____

Në pension: Po Jo

Vendbanimi: Rrogozhinë, Lagja nr. ____

Diagnozë sëmundje mendore: Po Jo Nëse po, specifiko: _____

I infektuar me COVID – 19: Po, aktualisht Jo Nuk jam i / e sigurt E kam kaluar

CHECKLIST

Deklarata	Vendos kryq tek të aplikueshmet	Mundësitë e referimit
A. Situata Ekonomike		
<i>Qëllimi: Personeli mjekësor vlerëson nevoja të shtuara socio-ekonomike që pacienti ka si pasojë e situatës së krijuar nga COVID-19 dhe e referon atë në shërbime të tjera të specializuara, sipas nevojave të identifikuara.</i>		
A1. Statusi ekonomik i pacientit është nën mesataren		Zyra e shërbimit social në Bashkinë Rrogozhinë
A2. Pacienti ka humbur punën si pasojë e pandemisë		Zyra e shërbimit social në Bashkinë Rrogozhinë, Zyra e Punës në Bashkinë Rrogozhinë
A3. Situata ekonomike është përkeqësuar si pasojë e pandemisë		Zyra e shërbimit social në Bashkinë Rrogozhinë
A4. Pacienti nuk përdor maskë dhe nuk ndjek procedurat higjienike si pasojë e pamundësisë ekonomike		Zyra e shërbimit social në Bashkinë Rrogozhinë

CHECKLIST

Deklarata	Vendos kryq tek të aplikueshmet	Mundësitë e referimit
-----------	---------------------------------	-----------------------

B. Rrezik

Qëllimi: Personeli mjekësor vlerëson nëse pacienti ndodhet në situata të cilat rrisin rrezikun e tij/saj për t'u infektuar me Covid - 19. Në këto raste, pacienti këshillohet nga personeli mjekësor dhe/ose referohet në shërbime të tjera të specializuara.

B1. Pacienti është me Sindromën Down		Mjeku këshillon pacientin/kujdestarin për masat shtesë që duhet të marrë për parandalimin e infektimit;
B2. Pacienti banon në banesë të papërshtatshme (tendë, kasolle, barakë etj.), me akses të limituar ndaj ujit të rrjedhshëm		Zyra e shërbimit social në Bashkinë Rrogzhinë
B3. Pacienti ka një familje të madhe dhe jetojnë të gjithë në të njëjtën shtëpi		Linja e Gjelbër 0800 40 40; Mjeku këshillon mbi rëndësinë e përdorimit të maskës, higjienizimin dhe distancimin social Brenda shtëpisë
B4. Pacienti është neglizhues ndaj pasojave të Covid-19		Mjeku këshillon mbi rëndësinë e përdorimit të maskës, higjienizimin dhe distancimin social
B5. Pacienti ndan një shtëpi me njerëz të moshuar dhe/ose me persona me shëndet të kompromentuar		Mjeku këshillon pacientin mbi masat mbrojtëse shtesë; Zyra e shërbimit social pranë Bashkisë Rrogzhinë

Deklarata	Vendos kryq tek të aplikueshmet	Mundësitë e referimit
-----------	---------------------------------	-----------------------

C. Gjendja Psikologjike

Qëllimi: Vlerësohet nëse pacienti shfaq shenja të gjendjes psikologjike të rënduar si pasojë e situatës së krijuar nga Covid - 19. Në rast se po, referohet në shërbime të tjera të specializuara, struktura të brendshme të qendrës shëndetësore ose shërbime të tjera.

C1. Pacienti është tej mase i shqetësuar për pandeminë e COVID-19		Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza 116117; Linja e Gjelbër 0800 40 40
C2. Pacienti tregon shëndet të përkeqësuar si pasojë e covid-19, edhe pse nuk është i infektuar		Psikologu i qendrës shëndetësore, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza 116117; Linja e Gjelbër 0800 40 40

CHECKLIST

C3. Pacienti ka humbur një të afërm si pasojë e pandemisë		Psikologu i qendrës shëndetësore, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza 116117; Linja e Gjelbër 0800 40 40
C4. Pacienti tregon shëndet mendor të përkeqësuar si pasojë e pandemisë (simptoma ankthi, depresioni, zemërimi)		Psikologu i qendrës shëndetësore, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza 116117; Linja e Gjelbër 0800 40 40
C5. Mënyra e jetesës së pacientit ka ndryshuar jashtëzakonisht shumë si pasojë e pandemisë		Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza 116117; Linja e Gjelbër 0800 40 40
Deklarata	Vendos kryq tek të aplikueshmet	Mundësitë e referimit

D. Dhuna në familje

Si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, viktimat e dhunës në familje kanë vështirësi më të mëdha për të raportuar dhunën. Nëse personeli mjekësor identifikon shenja të dhunës në familje tek pacienti, e referon atë në shërbimet dhe strukturat përkatëse për të raportuar dhunën ose për të marrë mbështetje të mëtejshme.

D1. Pacienti ka shenja fizike të cilat mund të përkojnë me dhunën në familje		Koordinatori Vendor i MKR të rasteve të dhunës në familje pranë Bashkisë Rrogozhinë, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza 116117
D2. Pacienti referon dhunë në familje		Koordinatori Vendor i MKR të rasteve të dhunës në familje pranë Bashkisë Rrogozhinë, Komisariati i Policisë, Eksperti Mjeko-Ligjor, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza 116117
D3. Pacienti ka nën kujdestari fëmijë të cilët shfaqin shenja të dhunës në familje dhe/ose referojnë dhunë në familje		Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës pranë Bashkisë Rrogozhinë, Komisariati i Policisë, ALO 116111

Shënim: Ky material është përgatitur nga Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, në kuadër të projektit "Përmirësimi i Ofrimit të Shërbimeve Lokale të Mbrojtjes Sociale", një iniciativë e përbashkët e Programit të UN, zbatuar nga qeveria shqiptare në partneritet me katër agjenci të UN, ku përfshihen UNDP, UNICEF, UN Women dhe WHO me pjesëmarrjen e UNFPA dhe ILO dhe financuar nga Joint SDG Fund. Programi mbështet qeverinë shqiptare për të përkthyer politikat në aksione të prekshme lokale në mënyrë që burrat, gratë, vajzat dhe djemtë që jetojnë në varfëri ose në situata vulnerebël, të kenë akses në shërbime të përkujdesjes sociale të integruara dhe cilësore dhe mbështet vizionin e një Shqipërie gjithëpërfshirëse.